

---

**ZYRA E PROJEKTEVE**  
BIRO ZA PROJEKTE – PROJECT OFFICE

---

Për : z. Qemajl Mustafa, Kryetar i komunës

Nga : Fadil Osmani, Menagjer i zyres se projekteve

Data : 16/01/2011

Lënda : Raport - Zyra e projekteve janar – dhjetor 2011

Të nderuar !

Duke u bazuar konform ligjit mbi shërbimin civil të Kosovës, në të cilat thuhet ku kontratat e punës përtrihi vetëm në bazë të vlersimit pozitiv nga ana e punëdhënsit, në këtë rastë të Kryetari të Komunës, e kam për obligim të doërzoj raport vjetor të Zyres se projekteve .

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, ju ofroj :

a) Raportin e punës për periudhen : janar - dhjetor 2011

Raporti perfshin :


- Hyrje
- Organogrami i komunes - Drejtorit komunale dhe komitetet
- Organogramin e zyres se projekteve dhe detyrat

Pastaj rapporti perfshinë bashkepunimin me :

- Drejtorit Komunal dhe Komitetet
- Organizata Ndërkombëtare dhe Institucionet tjera financiare
- Qeverinë e Republikës së Kosovës
- Komunitetin Lokal – pricipipimet në projekte
- Komunitetin fetarë
- Shoqerin Civile - organizatat dhe shoqatat e ndryshme
- Ndermarjet publike
- Institucionet bankare dhe komunitetin e biznesit

## Organogrami i komunës

Drejtorit komunale dhe komitetet - 2011



Ndryshe, Kuvendi Komunal i Gjilanit, ka nëntë komite:

Dy të obligueshme:

Komititin për politikë dhe financa dhe  
Komititin për komunitete,

Shtatë të tjera, të cilët përbëhen nga ekspertë  
të lëmive përkatëse, që nuk është e  
domosdoshme të jenë nga radhët e  
këshilltarëve komunalë.

Komititetet kanë zgjedhur edhe kryesuesit dhe  
zëvendëskryesuesit e tyre. Kështu, Komitetin  
për politikë dhe financa, sipas rregullores, e  
udhëheq kryesuesi i Kuvendit, Izmi Zeka.

Komititin për komunitete do ta kryesoj  
Kemal Shahin, Komitetin për arsim – Ejup  
Haziri, Komitetin për kulturë, rini dhe sport –  
Tahir Arifi, Komitetin për planifikim dhe  
urbanizëm – Florina Zyberi, Komitetin për  
prone, kadastër, banim – Ali Arifi, Komitetin  
për shëndetësi dhe mirëqenie sociale –  
Abdylatif Latifi, Komitetin për shërbime  
publike dhe emergjencë – Shaqir Shaqiri,  
Komititin për zhvillim ekonomik – Elisah  
Ymeri.

Përbërja e Qeverisë Komunale 2011 :

Drejtori i Drejtorisë se Arsimit – Bujar Nevzati

Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – Xhemajl Salihu

Drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – Bahrije Mahmuti

Drejtor për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim – Gani Neziri

Drejtor i Bujqësisë dhe Pylltarisë – Nazmi Rapuca

Drejtor për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – Nuhi Nuhiu

Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – Behar Mehmeti

Drejtor i Administratës së Përgjithshme – Arben Dubova

Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim – Blerton Ajeti

Drejtor i Drejtoratit të Inspeksionit – Ismet Hajdini

Drejtor i Drejtoratit për Rini, Kulturë dhe Sport – Selver Xhelili

## Aktivitetet e zyres se projekteve !


Specifikacioni dhe funksionimi - 2011

Zyra e projekteve funksionon ne kuader te zyres së kryetarit të komunës, merrë detyra dhe urdhra nga kryetari i komunës si dhe raporton për punët e kryera . Skema e orgaizimit :



Zyra e projekteve në kuadër të detyrave bënë përpilimin - përgatitjen dhe arsyetimin e projekteve ideore si dhe konkuron me projekte dhe programe ne programet e Organizatave Nderkomtare ( Donatorëve) dhe të gjitha programeve tjera të ofruara për financim të projekteve, bënë seleksionimin e projekteve me prioritet ne bazë të drejtorive dhe tipologjisë së projektit, bënë monitorimin e projekteve, gjetjen e donatorëve për thithjen e investimeve nga donatorët e huaj. Bashkëpunon ngushtë me drejtorit komunale, drejtorit e shkollave, me komitetet perkate, bashkëpunon ngushtë me Qeverinë e Kosvës, Shoqerinë Civile, Ambasadat dhe Zyret Ndërlidhëse te akredituara në Kosovë, me KFOR-in, Policinë e Kosovës me FSK-n, Bashkëpunon ngushtë dhe koordinon te gjitha punët lidhur me projektet me byrot projektuese të kontraktuara nga ana e komunës për përgatitjen e projekteve kryesore, bashkëpunon ngushtë me zyrën e prokurimit, si dhe kryen të gjitha punët tjera lidhur me projektet, përgatitjen e formularve PIP per MEF, mer pjesë në përgatitjen e buxhetit – për pjesen e investimeve publike, organizon debate publike – rreth investimeve ..

Zyra për projekteve pranon kërkesëa nga :



Zyra e projekteve gjatë këtij viti zyra e projekteve ka realizuar një mori aktivitetesh prej të cilave vlen të theksohen :

<b>Ativiteti</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Matje ne teren per Punimin e paramasave për kubëza në disa pjesë të Qytetit( trotuaret), sheshve (Atik Xhamia-Dr.Rexha parkingu,Sheshi te QKMF në Lagjen Dardania) si dhe disa rrugë në qytet</li> <li>• Punimi i paramasës për Banim Social- (adaptimi i lokaleve afariste te banimi social ne dy banesa dhe vendosja e dy familjeve)</li> <li>• Matja si dhe Punimi i paramasës dhe projektit për raste sociale në Fshatra si dhe për disa raste sociale në Qytet</li> <li>• Matja si dhe Punimi i paramasës së oborrit të Qerdhes dhe Rrethojës së oboorit në fshatin Shillovë dhe monitorimi i projektit</li> <li>• Punimi i projekteve për donacion "Kosova e Bukur" 2011</li> <li>• Dalja në teren si dhe matja e objekteve të Konviktit dhe Sh.M."Zenel Hajdini" (vizatimi i tyre) për projektin e eficiencës së energjise</li> <li>• Dalja në teren si dhe matja e objekteve të QKMF në qytet dhe në fshatra si dhe punimi i te gjitha projekteve (vizatimi i tyre) dhe dorzimi i tyre ne DSHMS</li> <li>• Punimi i paramasës së banesave Kolektive në Lagjen Iliria projekt i finançuar nga Banka Botërore Fasadimi i Objekteve</li> <li>• Vizita, Matja si dhe punimi i paramasave të gjitha shkollave Fillore dhe të Mesme në Fshatra dhe ne Qytetë për lyerje,dyshemet në disa shkolla dhe sanitariet dhe dorzimi i reportit dhe paramasave (paramasa 27 ) në Drejtoriin e Arsimit</li> <li>• Punimi i projekteve si dhe paramasat për Bankën Botërore- projekti i kubëzave, fasadimi i objekteve Kolektive "lagja Iliria2", dhe dorzimi i tyre në Bankën Botore në bashkëpunim me Qendrën për Punësim</li> <li>• Matja si dhe Punimi i paramasës së objektit të Qerdhes "Ardhmëria 2" aneksi i qerdhes</li> <li>• Dalja në teren si dhe e kontrollimi i projekteve të cilat janë duke u punuar nga K.Komunan Gjilan si dhe nga Donatorët e ndryshëm</li> <li>• Matja si dhe Punimi i paramasës së murit rrëthues për shtëpitë e Romëve të punuara nga UNDP</li> <li>• Matja si dhe Punimi i paramasës së terenit sportiv për dy fusha të sportit në shkollën fillore në Velekicë</li> <li>• Matja si dhe Punimi i paramasës së objektit të PDK për renovimin e objektit</li> <li>• Dalja në teren si dhe punimi i planifikimit të oboorit të Sh.F. "Agim Ramadani" në Zhegër</li> <li>• Dalja në teren si dhe punimi i planifikimit të oboorit të Sh.F. "Vebi Ibrahim" dhe QMF në Uglar</li> <li>• Punimi i projekteve në sistemin PIP për projektet kapitale të komunes 2012-2014 dhe dorzimi i tyre ne Ministrin e Financave</li> <li>• Matja si dhe Punimi i paramasës së aneksit të objektit të Zjarrfiksëve</li> <li>• Vlersimi i ofertave te finançuara nga K.Komunal – Gjilan dhe nga Donatoret e ndryshem</li> <li>• Punimi i projektit te Arkivit Ndërkombunal</li> <li>• Punimi i Paramasës së Aneksit të shkollës "Selami Hallaqi"-për lyerje</li> </ul>

Zyra e projekteve me kerkese te drejtorive te shkollave, komunitetit dhe institucioneve tjera ka kryer edhe keto projekte ::

<b>Lokacioni</b>	<b>Emri i institucionit</b>	<b>Emri i projektit</b>
Mihir	sh f. "Vesel Muji"	Gardhi mbrojtës si dhe Teren sporti-/fushë futbolli të vogël, hendbolli/
Uglar	sh f. "Vehbi Ibrahim"	Teren sporti-/fushë futbolli të vogël, hendbolli/, Gardhi rrëthues, platoja dhe stazat
Ponesh	Komuniteti	Teren sporti-/fushë futbolli të vogël, hendbolli/
Doberqan	shf. "Nazim Hikmet"	Gardhi mbrojtës
Perlepnice	shf. "Skënderbeu"	Depo për deponimin e materialit drunor për nxehje qendrore
Pogradjë	QKMF	Rekonstruktim i kulmit dhe Gardhi rrëthues
Bresalc	shf "Ibrahim Uruqi"	Ndërtimi i kulmit të pjerrë të sallës për edukatë fizike
Gjilan	shf "Abaz Ajeti"	Rekonstruktim i kulmit
Livoq i ulët	shf "Dëshmorët e kombit"	Ndërtimi i kulmit- mbulesës te hyrja dhe platoja tek pjesa hyrëse në shkollë
Livoq i epërm	Komuniteti	Teren sporti-/fushë futbolli të vogël, hendbolli/
Lladovë	shf "Agim Ramadani"	Teren sporti-/fushë futbolli të vogël, hendbolli/
Gjilan	Qmf "Dardania"	Depo për deponimin e materialit drunor për nxehje qendrore
Zhegër	shf " Agim Ramadani"	Gardhi rrëthues
Gjilan	shf " Musa Zjmi"	Gardhi mbrojtës
Llashticë	Rast social	Paramasa dhe paralogarit për rekonstruktimin e kulmit
Gjilan	Sindikata Gjilan	Paramasa dhe paralogarit për murin ndarës
Shillove	ZLK	Paramasa për rrëthojnë e shkollës dhe çerdhes

*Zyra e projekteve ka koordinuar veprimet edhe me organizta nderkombëtare dhe institucionet tjera lokale te cilat kane vepruar ne Komunene e Gjilanit*

Përshkrimi i Aktivitetit
Punimi paramanës dhe paralogarite për instalimin e ngrohjes qendrore, shkolla fillore „Abaz Ajeti” -Gjilan
Pjesëmarrje në grupin punues komunal për bashkëpunim me CDI në. Grumbullimi i shënimave për Komunën e Gjilanit (Qyteti dhe fshatrat): popullatën, ekonomitë familjare gjendjen aktuale te furnizimit me ujë , gjendja e kanalizimeve fekale ,kapacitetet aktuale etj, pastaj caktimi i koordinatave ne teren për te gjitha: puset e ujit, stacionet e pompimit dhe rezervuarët .
Pjemarrje ne projektin : hapja e puseve dhe rregullimi i ujësjellësit për familjet serbe ne fshatin Budrike e financuar nga UNDP si dhe Banesa Sociale -Adaptimi i lokaleve afariste për banim
Bashkëpunimi me programin USAID-DEMI : Rregullimi i zyrës: ngjyrosje , rregullimi i laminatit dhe furnizimi me tepison dhe përgatitja si dhe dorëzimi i projektit në USAID-Prishtinë : Shtrimi i trotuareve me kubeza të betonit
Bashkëpunimi me Qendra Rinore rrethe adaptimi i zyrave dhe nyejve sanitare si dhe pjesëmarrja ne komisionin : Regjistrimi i inventarit dhe pasurisë komunale - komisioni qendror për regjistrim.
Bashkëpunimi me AKP dhe MEF ( sektori i vlerësimit te pronave) : Grumbullimi i shënimave dhe përgatitja e lendeve për pronat me interes te veçan për Komunën e Gjilanit dhe propozimi për ndërrim me AKP : Pronat e propozuara për ndërrim: Fidanishtja (Don Bosko) pasta Objekti i pylltarisë (shkollat e mesme), Çerdha Integj, Vetëshërbim Pireva, kooperativa bujqësore ne fshatin Shurdhan , pastaj nxjerrja ne Drejtoratin e Gjeodezise te kopjeve te planit dhe fleta poseduese për pjesën e Aeroportit Bujqësor (ndërtimi i trafostacionit te ri), si dhe kompletimi i dokumentacionit për pronat me interes te përbashkët publik, formulimi i kérkesës për shndërrim te pronave me AKP-në.
Bashkëpunimi me Agjénësin për Zhvillim Ekonomik Regional .Takim ku janë paraqitur progresit e arritura nga CARE Internacionale dhe SPARK, po ashtu bashkëpunimi me RDA - Programi EURED GS2. Krijimi i ideve te reja për projekte.
Drejtatori i Gjeodezise : Vërtetim me shkrim ,se realizimi i projekteve - Rregullimi i shtratit te lumi Baja dhe asfaltimi i rrugës Velekince-Deponia e qytetit nuk kane probleme pronësore juridike, Komisioni për miratimin e planit rregullativ -Kompleksi e shkollave te mesme"
Përgatitja e aplikacioneve,projekteve dhe dokumentacioneve te nevojshtme për 5 (pesë) shkolla te komunës për aplikim ne IPA .
Programi „Masat për ruajtjen e energjisë” (Dorëzimi në MAPL)
Grupi punues komunal për bashkëpunim me CDI, takimi është mbajtur ne objektin e Hidromoraves, ku është bere caktimi i prioriteteve për investime në ujësjellës dhe kanalizim (trajtimi i ujërave fekale)
Përgatitja e paramasave dhe paralogarite : Shkolla fillore "Selami Hallaqi " : Renovimi i zyrave dhe muzeut të Shkollës, pastaj Qendra Rinore Renovimi i zbrës dhe nyejve sanitare, Shkolla fillore „Mulla Idrizi ” - Velekince : Ndërrimi i dyerive te shkollës, Konvikti Komunal Gjilan Rregullimi i rrjedhjeve te ujit, Shkolla fillore "Thimi Mitko -Gjilan : Punimi i binës për nxënës .
Po ashtu është bere edhe hartimi i paramasave për furnizimin e shkollave me ujë të pijshëm : shkolla Fillore „Agim Ramadani ” -Zhegër dhe Nasalë dhe shkolla fillore Ponesh, si dhe kemi marrë pjese në grupin për planifikim, kompleksi i shkollave te mesme.
Grumbullimi i shënimave ,hartimi i projekteve ,plotësimi i formularëve për shkollat dhe institucionet e tjera shkollore për aplikim në programin IPA-për eficiencë të energjisë : Menaxhuar nga MAPL.
➤ Gjimnazi Zenel Hajdini -Gjilan. ➤ Konvikti i nxërëseve -Gjilan ➤ Shkolla Fillore „Skënderbeu ”-Perlepnic ➤ Shkolla Fillore „Ramiz Cernica ”-Cernicë. ➤ Shkolla Fillore „Dëshmorët e Kombit ”-Livoqi i Ulet.
Auditimi nga byroja projektuese "Eptisa" për shkollat e propozuara në projektin e IPA-MAPL. / Konvikti dhe shkolla ne fshatin Cernicë/
Grumbullimi i shënimave për hartimin i projekteve për aplikim në IPA për projektin : Rregullimi i tregut të gjelbër - Gjilan
Konkurrim ne programin - projektet me MPMS-Punët Publike " Kosova 2011" ku janë dorëzuar këto projekte : Shtrimi i trotuareve me

*Të tjera :*

*Në vazhdim po japim detalishte bashkëpunimin me secilen organizat nderkombetare, ministrit, institucionet tjera lokale e nderkomebetare, raste sociale, çeshtjen e komuniteteve dhe shoqerin civile .*

Zyra e projekteve në kuadër të detyrave bënë përpilimin - preqatjen dhe arsyetimin e projekteve ideore si dhe konkuron me projekte në programet e Organizatave Ndërkombëtare ( Donatorëve) .

Gjatë vitit 2010/2011, zyra e projekteve ka aplikuar me projekte dhe është duke bashkëpunuar me këto Organizata Ndërkombëtare dhe Institucionet tjera financiare

**USAID - Unitet States Agency for International Development:** Falë angazhimit te Zyres se projeteve dhe aplikimit, në programin Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI), gjate muajit janar jemi njoftuar nga USAID se në mesin e 15 komunave të Kosovës është përzgjedh edhe komuna e Gjilanit, si komunë partnere duke u bazuar në sistemin garues të komunave . Programi për Partneritet në projektin Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (IKDE) / Democratic Effective Municipalities Initiative (DEMI) të USAID-it është projekt i cili u dedikohet komunave që të promovojnë, implementojnë dhe të inkurajojnë një qeverisje të mirë komunale, programi ka objektiv të ndihmoj në ndërtimin e kapaciteteve komunale në mënyrë që të ngritet aftësia për të ofruar shërbime ndaj qytetarëve.

Programi është i përbërë nga pesë komponentë kryesore: Fuqizimin e administratës komunale, fuqizimin e asambleve komunale, mbështetjen për pjesëmarrjen e qytetarëve në organet vendimmarrëse, përmirësimin e shërbimeve publike dhe promovimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Iniciativa për Komuna Demokratike Efektive e USAID-it është program tre vjeçar dhe është i dizajnuar ti mbështesë Komunat e Kosovës për të ofruar shërbime me te mira për qytetaret dhe të promovojet qeverisje te mirë lokale, Iniciativa për Komuna Demokratike Efektive implementohet nga Institut Urban.

- Programi Iniciativa për Komuna Demokratike Efektive e USAID-i – nga data 2-4 mars dhe nga data 22-24 qershor ka mbajtur trajnimin me temen “Zhvillimi ekonomik lokal pro-aktiv” dhe “Zgjerimi mundësive për ambient biznesor, ndersa nga data 09 – 18 shtator ne kuadër te këtij programi eshte bere një vizit ne SHBA (Auburn) ku jane marrë përvjetor ne ngritjen dhe iniciativat e zhvillimit ekonomik lokal .
- Ne kuader te këtij programi Komuna e Gjilanit – Zyra e projekteve eshte duke u përgatitur edhe profili i Komunes qe kryesisht do te jete zhvillimi ekonomik lokal – zonat ekonomike dhe sfidat .

Iniciativa për Komunat Demokratike dhe Efektive (DEMI), program i USAID-it, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Komunës së Gjilanit meritueshëm i kanë ndarë me datë 01/06/2011 një mirënjojje (shpërbirim financiar) për “Mirëmbajtjen e rrugeve, shesheve dhe gjelbërimit, me një grant në vlerë prej 45000 \$, mjete të cilat do të dedikohen në rregullimin e infrastruktura komunale .

- Komuna e Gjilanit keto mjete do ti destinoj ne rivitalizimin dhe zgjerimin e hapësirave publike gjelbruese nga se keto mjete don qe tju kthehen qytetareve te saj ,

Ne baze te nevojes dhe gjendejes ne teren kemi konstatuar se nevoj emergjente dhe shume prioritare eshte realizimi gjegjësisht bashkefinancimi i projektit : *Rregullimi i trotuarit nga Qendra e qytetit në drejtim të shkollës filllore “Abaz Ajeti”* e cila eshte realizuar – implementuar gjate muajve tetor – nentor 2011, ne fillim të muajit dhjetor projektit në fjalë është kompletuar, me date 13 dhjetor Kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe drejtoresha e Programit Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive e USAID-it, Ginka Kapitanova kanë përruuar trotuarin e rregulluar, nga qendra e qytetit deri në lagjen Arbëria, me një hapësirë mbi 2710 m<sup>2</sup>, vlera e tij e përgjithshme është 46 779 \$

Iniciativa për Komunat Demokratike dhe Efektive (DEMI), program i USAID-it, ka marrë per obligim financimin e projektit : *Ndricmit publike ne lagjen Dardania I*, e cila eshte tenderuar gjate muajit nentor 2011 dhe pritet te finalizohet deri ne funde te vitit.

Komuna e Gjilanit ne bashkëpunim me Iniciativa për Komunat Demokratike dhe Efektive (DEMI), program i USAID-it planifikon te realizoj edhe disa projekte si : *Rregullimi i rrethrrrotullimit në lagjen Kamnik (Jugu1)* dhe disa projekte

tjera te cilat do te ndikojne ne zvoglimin e problemeve me te cilat ballafaqohen qytetaret , procedurat per keto projekte kane filluar te zhvillohen gjatë fundit të vitit 2011 .

## **ECLO - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian – Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA)**

Komuna e Gjilanit shprehë interesim dhe ka aplikuar në Programin Komunal për Zhvillim të Infrastrukturës Ekonomike dhe Sociale që ka për qëllim të përkrah implementimin e kërkesave të Partneritetit Evropian ( në veçanti atyre që kanë të bëjnë me nivelin komunal), përmes përmirësimit të shërbimeve komunale duke përfshirë zhvillimin e mëtejmë të tyre.

Pas takimeve te shumta dhe vizitave ne teren programi IPA (byroja projektuese Eptisa) ka mare per obligim dhe ka konfirmuar financimin e projektit : Ndertimin e objektit te shkolles fillore ne fshatin Pasjak, dhe pse tani ky fshat kalon nen komunen e Novoberdes, Komuna e Gjilanit nuk ka ndryshuar prioritetin e saj, nga se eshte një projekt shum i domosdoshem per kete lokacion dhe financimin e projektit : *Ndertimi i Bibliotekes Rajonale*, e cila pas përgatitjes se projektit kryesor pritet te tenderohet gjate muajit maj 2011.

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian shpallë tenderin në web faqen : [www.delprn.ec.europa.eu](http://www.delprn.ec.europa.eu) , me numer te references Europe Aid/130900/C/WKS/KOS tenderi mbyllt me 03/08/2011 .

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian ka mbështeture programin : Mbeshtetja Ekonomike Rajonale me numer te references EuropeAid/131-065/L/ACT/XK, afati i fundit per aplikim ka qen 2 gusht 2011 .

Komuna e Gjilanit gjate muajit gusht e ka kontraktuar dhe e ka rrnuar objektin si dhe ka bere pastrimin e terenit te lokacionit te ish TMKsë, ndersa gjate fundit te muajit tetor 2011 është bërë përzgjedhja e kontraktuesit – punëkryesit që është kompania Albes – Istogu .

Zyra e projekteve me kohe ju ka perqigjture kerkeses se Ministrise se Administrimit te Pushtetit Lokal dhe Zyres Ndërlidhëse e Komisionit Evropian dhe ka aplikuar me projekt në bazë të nevojës dhe gjendjes ne teren ku kemi konstatuar se nevojë emergjente dhe shume prioritare është realizimi i projektit :

- *Ndërtimi i fushës së futbollit (stadionit ndihmës) mbi palestrën e sporteve – Gjilan, qëllimi i projektit* : Krijimi i hapësirave për ekipet e futbollit të regjistruara zyrtarisht në Federatën e Futbollit të Kosovës

Gjatë fundit të muajit nëntor Komuna ka dhane pëlqimin dhe ka ma per obligim se do të siguroj falas lejen e nevojshme të ndërtimit dhe lidhjen e ndërtesës së re me infrastrukturre teknike dhe pas pranimit final të projektit nga Inxhinieri, Komuna lëshon Certifikatën e shfrytëzimit, kjo shkrese i ka hapure rrugen Zyres Ndërlidhëse të Komisionit Evropian për të tenderuar këtë projekt .

## **TIKA - Turkish International Cooperation & Development Agency** – Zyra e projekteve në saje të bashkëpunimit te mirë me këtë organizatë ka arritur qe 10 fermerë gjilanas te marrin pjese në një seminar që ka organizuar Organizata Qeveritare Turke “TIKA”, fermeret nga ky seminar kanë fituar njohuri të reja rreth kultivimit dhe trajtimit të kulturave bimore – serave, fermerët janë shprehur të kënaqur me këtë seminar i cili eshte mbajtura ne Adana të Turqisë nga data 09 janar deri me daten 16 janar 2011ne Instituti per Kultivimin dhe Mbrotjtjen e Bimeve, kështu ata kanë arritur të krijojnë dhe shohin një përvojë të mirë në fushën e bujqësisë. Turkish International Cooperation & Development Agency (TIKA) – ka mare per obligim edhe realizimin e dy projekteve :

- Ndertimi i Objektit te Medreses “Alaudin” ne Gjilan dhe
- Rregullimi i shtratitit te lumbit dhe rrjetit te kanalizimit ne fshatin Doberqan

Projekti “Ndertimi i Objektit te Medreses “Alaudin” ne Gjilan eshte ne fazen perfundimtare te realizimit, pritet qe deri ne fund te muajit tetor te kompletohet projekti sa i perket fazes se ndertimit, ndersa projekti do te kompletohet edhe me inventare te nevojshem,

Projekti Rregullimi i shtratitit te lumbit dhe rrjetit te kanalizimit ne fshatin Doberqan edhe pse eshte kontraktuar ende nuk ka filluar edhe pse shume here eshte kërkuar sqarime rrethe këtij projekti nuk kemi arritur te sigurojm një inforamt te tille .

Në fundë të muajit nëntorë 2011, Komuna e Gjilanit dhe Komuna Nazili nga Republika e Turqisë, përmes kryetarëve Qemajl Mustafa, përkatësish Haluk Alicik, kanë nënshkruar marrëveshjen e binjakëzimit, e cila nuk ka kufizime

kohore. Nazili është kjo komuna e dytë për nga madhësia në Turqi dhe e dyta me të cilën binjakëzohet Gjilani me komuna të këtij shteti.

Të pranishëm në këtë binjakëzim pos zyrtarëve më të lartë të Komunës së Gjilanit, përfshirë këtu edhe shefat e grupeve parlamentare të Partive Politike në Kuvendin Komunal, ishin edhe delegacioni turk i kryesuar nga kryetari Haluk Alicik dhe gjithashtu edhe drejtori i Institutit Junu-Semra, polic të kontingjentit turk në EULEX, dy nënkyretarë të Komunës Nazili, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të Ambasadës Turke në Prishtinë dhe zyrtarë të tjerë Komune.

**CDI – Community Development Initiatives / Prizren :** projektet e organizates CDI mbeshteten finaciarisht nga Agjencioni Zvicran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA),

Faza e parë :

- Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit Malisheva e Epërme dhe e Ulët – Kufca e Ulët
- Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizmi Velekincë – Pasjan
- Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizmi Pasjak – Koretishtë

Faza e dytë :

- Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Miresh / Doberqan
- Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit ne fshatin Llovçë
- Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit ne fshatin Zheger dhe Budrikë

Faza e tretë :

- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërrnicë
- Vazhdimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i gropës septike në Partesh
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit ne fshatin Lladovë dhe Nasal

Projektet e organizates CDI mbeshteten finaciarisht nga Agjencioni Zvicran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), pasi komisioni ne perberje Komune (zyra e projekteve dhe drejtoria e sherbiemve publike) dhe CDI ka identifikuar problemet e infrastrukturës ne komunën tonë CDI ka aprovuar në parim realizimin e ketyre projekteve :

- Bresalcë dhe Ponesh - Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit
- Pogradjë - Rregullimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimit e impiantit per trajtimin e ujërave të zeza

Me 2 dhjetor 2011, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) ka nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim për projektin "Programi i Mbështetjes së Ujtit dhe Sanitacionit në zonat rurale, faza IV" që do të implementohet në Kosovën Juglindore.

Marrëveshja është nënshkruar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj dhe drejtori i Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovës, Markus Baechler, ndërsa parashev që Programi i Mbështetjes së Ujtit dhe Sanitacionit në zonat rurale të financohet me 2 milionë e 250 mijë CHF nga Qeveria Zvicerane dhe 940 mijë euro nga Qeveria e Kosovës.

**G I Z – German International Cooperation :** ne bashkpunim me Ministrin e Energjisë dhe Minierave si dhe Komunen e Gjilanit ka realizuar programin : zbatimin e masave të eficiencës së energjisë ne institucione publike të palnit kombëtar të EE-së sipas standardeve të BEsë (furnizimi, reahbailitimi dhe instalimi i poqave eficiente)

- Gjate kësaj faze janë realizuar me ndriqim publikë rrugët : lagjeja Arberia, Iliria, Dardania dhe rruga e Prishtinës, rruga nga Xhamia e Madhe deri te rruga Qarkore
- GTZ dhe Ministria e Energetikes dhe Minierave MEM ne parim kan aprovuar dhe kan realizuar projektin e ndriqimit publikë ne qytet (ndrimi i poqeve eficiente) vlera e insvetiemve eshte 94.086.00 € (3 x 31.362.00€) viti i realizimit 2010/2011

Në kuadër të Projektit të GIZ-së për „Zhvillim Ekonomik Rural“ eshte organizuar një vizitë studimore ne vendet fqinje si në Republikën e Shqipërisë dhe Maqedonisë. Qëllimi i kësaj vizite ishte iniciimi i bashkëpunimit ndërkufitarë i cili do te kontribuoje zhvillimin ekonomik në regjionin e Sharrit dhe regjionin e Gjilanit duke i përfshi komunat përfshirëse në Republikën e Kosovës si dhe komunat e vendeve fqinje që janë pjesë e zonës kufitare. Prandaj, ky projekt do te përkrahë iniciativat private dhe institucionet publike të cilat do t'i i iniciojnë dhe zhvillojnë projektet për bashkëpunim ndërkufitarë në harmoni me rregullat dhe parimet e Bashkësisë Evropiane. Iniciativat regionale do të shërbejnë për rritjen e aftësisë konkurruese të këtij regjioni. Në bashkëpunim me partnerë tjerë regionalë do të përkrahen ndërmarrjet ekzistuese private ne ngritjen e aftësisë konkurruese dhe në zgjerimin e prodhimitarisë se tyre, ne mënyre qe banorëve/popullsise të i ofrohet perspektivë dhe punësim në ketë region.

Në kuadër të Projektit të GIZ-së për „Zhvillim Ekonomik Rural“ eshte organizuar edhe një vizitë studimore në Gjermani edhe ate nga data 03 – 08 tetor 2011 ku jane vizituar shume ekonomi dhe biznese familjare .

**Balkan Net -** Ky projekt financohet nga organizata GIZ, ndërsa e menaxhon Balkan Net : gjatë fillimit të muajit dhei, Kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe drejtori i Fondacionit Ndërkombëtar "Balkan Net", Jean Stanoevski me seli në Shkup, kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi për bashkëpunim mes dy administratave të Gjilanit dhe asaj të projektit Balkan Net "Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme dhe eficiencën e energjisë në Evropën Juglindore".

Në kuadër të këtij projekti, do të caktohen ekspertë ndërkombëtarë e kombëtarë, për të siguruar të dhëna të nevojshme dhe përpunimin e tyre për qëllime të realizimit të projektit dhe përgatitjen e studimit.

Studimi do të bëhet për të mbledhur të dhënat për gjendjen e kérkesës për ngrohje për ekonomitë familjare, objektet komunale, bizneset dhe të tjera, gjendjen e konsumit të energjisë, për ekonomitë familjare, komunën dhe bizneset, planin urbanistik në komunën e Gjilanit, përdorimi i objekteve komunale, siç janë zjarrfikësit, kopshtet e fëmijëve, shkollat e të tjera, përdorimi i ndërtesave komerciale, burimet e përdorura energetike në Gjilan dhe pastaj prezantimi i gjendjes në "work shop", diskutim me përfaqësuesit e qytetit, identifikimin e qasjeve strategjike për menaxhim të suksesshëm, zvogëlim të shpenzimeve dhe kursim të energjisë dhe definimin e hapave për implementim të këtij projekti.

**UNHCR - Zyra Ndërlidhese në Gjilan** - Zyra e projekteve ka përgatitur paramasën edhe paralogarit e projektit te rregullimit të rrithojës për objektet 6 familje Rome te cilat nga pas lufta jetojnë në Shkup - FYROM, qe tanë deshirojnë te kthehen në Gjilan . Zyra e projekteve me datën 26.10.2009 ka kërkuar nga :

- Drejtoria e Kadastrit dhe Prones : Te dal ekipi per matjen dhe parcelimin e sipërfaqes se lirë komunale, te cilat dedikohen per ndertimin e 6 objekteve te komunitetit rom dhe Drejtoria e Urbanizmit – sektori per planifikim : Te angazhoj ekipin – sektorin e planifikimit per përgatitjen dhe planifikimin e hapesires sipas te dheneve kadastrale dhe te jepin pelqimin dhe lejen urbanistike, ndertimi i shtepive eshte kontraktuar UNHCR dhe si punë kryese eshte shoqata "Developing Together " nga Prishtina .

**Caritasi i Luxemburgut** - Zyra e projekteve në saje të bashkëpunimit me këtë organizatë ka arritur të bashkëfinancoj këto projekte : Rrethoja e shkollës filllore " Avdullah Tahiri" Malishevë dhe Asfaltimi i rrugëve në fshatin Miresh, ndersa për vitet 2010/2011 (gjate muajit nëntor) ka nenhkruar memorandumet e mirekuptimit edhe për realizimin e këtyre projekteve te cilat bashkfinancohen nga Caritasi i Luxemburgut dhe Komuna e Gjilanit e keto projekte jane :

- Emri i projektit : Njerëzit për njerëzit : Për rinin, kulturën dhe sportin, participimi i komunes eshte 2.900 €, ndersa Caritasi i Luxemburgut participon me 10.000 €,
- Emri i projektit : Zëvendësimi i rrjetit elektrik në fshatin Malishevë e Epërmë, participimi Caritasi i Luxemburgut participon me 17.000€, pjesen mbi kete vlerë e mbulon Komuna e Gjilanit .
- Emri i projektit : Ndërtimi i trotuarit në fshatin Miresh, participimi Caritasi i Luxemburgut eshte 20.000€, pjesen mbi kete vlerën e mbulon Komuna e Gjilanit .
- Emri i projektit : Rrethoja e sodiumit në Miresh, participimi i Komunes së Gjilanit është 2.000€, Caritasit te Luxemburgut mbulon pjesen mbi këtë vlerë .

Projektet e organizates Caritasi i Luxemburgut kanë përfunduar gjatë muajit qershor 2011, kjo organizat e ka përfunduar misionin e vetë sa i perket programit të infrastrukturës të fazës së parë .

Caritasi i Luxemburgut përmesë strategjisë “ Zbutja e varfërisë përmes Zhvillimit të Qëndrushëm 2011/2013, programi financohet nga Qeveria e Luxemburg-ut ka aprovuar projektin me bashkëfinancim me komunën në fshatin Kishnapole e cila me daten 12/12/11 eshte nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit mes paleve .

Komuna e Gjilanit është e përzgjedhur për një investim në vlerë mbi 400 mijë euro, ku komuna e Gjilanit merr pjesë me 30 % të vlerës së përgjithshme në këtë projekt ndërsa pjesën tjetër prej 70% e mbulon “Caritasi”, investimet do të bëhen në tri sfera, në edukim, në shëndetësi dhe sektori tjetër është gjenerimi i të hyrave që do të punohet në komunitete. Synojmë të përmirësojmë jetën e këtyre banorëve në sferat e përmendura dhe përvèç këtyre i kemi edhe tri tema transversale siç janë përmirësimi i barazisë gjinore, parandalimi i konfliktit dhe mbrojtja e ambientit .

Tabela : obligimet e sipas marrëveshjes e mirëkuptimit :

Sektori	Caritasi i Luxemburgut	Komuna e Gjilanit
Arsimi	123,500.00	37,050.00
Shëndetësi	53,225.00	15,967.50
Gjerimi i të ardhurave	99,145.00	29,743.50
Ambienti	21,800.00	Sipas nevojave
Gjinia	4,675.00	Sipas nevojave
Paranalim konflikti	10,375.00	Sipas nevojave
Punëtoritë	3,739.75	1,121.93
Gjithësjetë	316,459.75	83,882.93
<b>Totali € (vitet 2011/2013)</b>	<b>400,342.68</b>	

**NORWAC (Norwegian Aid Committee)** - kjo organizatë financon dhe implementon projektin:

- Ndërtimi i objekteve për përsone me aftësi të kufizuar, pune kryese kompania “ Ceni Compani” e cila ka realizuar projektin gjate vitit 2010/2011

## **EU-CSP - EU COMMUNITY STABILISATION PROGRAMME- PROGRAMI I BE-së PËR STABILIZIM TË KOMUNITETIT**

projektet implementohen nga organizata IOM – INTERNATIONAL ORGANIZATION FOR MIGRATION, permes ketij programi tanë jemi duke realizuar – bashkëfinacuar projektin : Çerdhes së fëmijëve në fshatin Shillovë, ku IOM mbulon shumën prej : 17,530€, ndërsa Komuna e Gjilanit particion me vlerën 5.000 € .

Projekti i Çerdhes së fëmijëve në fshatin Shillovë është realizuar gjate muajit maj - qershor 2011

**UN HABITAT Kosovo :** Zyra e projekteve ka një bashekpunim te mire me kete institucion me te cilet bashkepunohet ne gjetjen e fondeve ne financimin e projekteve ne lokalitetet e perziera .

- Komuna e Gjilanit është mirënjohëse për bashkëpunimin ne mes Komunës se Gjilanit dhe UN Habitat-it për plotësimin e komponentës së Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban, respektivisht komponentës se Vlerësimit dhe Menaxhimit te Fatkeqësive dhe Krezikshmërisë, dhe identifikimit të projekteve për bashkëfinancim.
- Ne baze te nevojës dhe gjendjës ne teren kemi konstatuar se nevojë emergjente dhe shume prioritare është realizimi gjegjësisht bashkëfinancimi i projektit :
  - Përforcimi i strukturës dhe shtimi i hapësirës duke përmirësuar funksionalitetin e objekteve të Çerdhes së fëmijëve “Ardhmëria I” ne Gjilan, të dëmtuar nga tërmeti.
  - Lokacioni : Gjilan – afër shkollës fillore “Thimi Mitko”

Organizata UN HABITAT ka filluar realizmin e këtij projekti, pas krijimit te problemeve në këtë projekt / mungesa e stabilitetit / sipas komisionit punët janë ndërprerë dhe po shikohet mundesia qe ky investim te baretet ne lokacion tjetër, me qellim te krijimit të kushteve më të mira për nxënsit e shkolles fillore " Th. Mitko " .

## Ambasaden e Italisë në Prishtinë – Cooperazione Italiana allo Sviluppo Ministero Affari Esteri :

Projekti "Mbështetjen për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës" e përqëndruar në Gjilan si pilot projekt, financuar nga Bashkëpunimi Italian, ka publikuar një njoftim për kërkesën për pjesëmarrje në një përzgjedhje të kompanive të ndërtimit.

Kooperacionit Italian per Zhvillim Ministria Italiane e Punëve të Jashtme, Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrat dhe në partneritet me Komunën e Gjilanit, ku duke filluar prej muajit shtator 2010 jane implementuar pilot aktivitete me qëllim të promovimit të përfshirjes dhe mirëqenies se personave me aftësi të kufizuar, veçanërisht në fushën e qasjes fizike të ndërtuesave publike.

Të përfshira në këtë projekt në fazën e parë janë këto institucione : Palestra e Sporteve, Teatri i Qytetit, shkolla fillore Th. Mitko, "Selami Hallaqi" dhe shkolla e Muzikës, shkolla e mesme "Marin Barleti" dhe "Zenel Hajdini" si dhe Çerdhet e fëmijëve "Integj" dhe "Ardhmeria II" ne Gjilan, gjatë muajit maj 2011 është bërë inaugurimi i këtyre projekteve nga Ambasadori Italian .

Gjate vitit 2011, me qëllim të ngritjes së ndërgjegjësimit dhe për të nxitur një diskutim miqësore mes zyrtarëve të qeverise lokale, Organizatave të Shoqërisë Civile dhe ekspertëve në fushën e arkitekturës dhe të sektorit të ndërtimit në rajonin e Gjilanit me date 03 nentor eshte organizuar një punetori njeditore me temen : **"Qasja fizike drejt një të ardhme më të lehtë dhe më të mirë"**

Punëtoria do të mundësojë shkëmbimin e përvjovave në iniciimin e projekteve të reja dhe identifikimin e vepimeve e përshtatushme në tejkalimin e kufizimeve ekzistuese aktuale në aspektin e qasjes fizike.

Gjatë muajit nentor / dhjetor 2011 është publikuar dhe tenderi dhe është kontraktuarrë realizmii ketyre projekteve që përfshinë fazën e dytë që ka të bëj përmirësimin infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara (si pjerrina, rregullimi i nyjeve sanitare, dyerve etj) të objektet publike : Palestra Sportive, shkolla fillore Th. Mitko, "Selami Hallaqi" "Rexhep Elmazi", Teatri i qytetit, gjimnazi "Zenel Hajdini" Çerdheja "Ardhmeria II", shkolla fillore "Vuk Karagjic" në fshatin Kmetovcë dhe Fakulteti i Edukimit

**EULOG project - WNG International :** Projekti për mbështetje të Pushtetit Lokal të Kosovës (SLGK) është një projekt i sponsorizuar nga BE (EuropeAid 126494/C/SER/KOS) që është menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian-Kosovë dhe zbatuar nga VNG International dhe partnerët e saj të konsorciumit.

Projekti i përkrah komunat e Kosovës për të avancuar reformat dhe ndërtimin e kapaciteteve në kontekstin e procesit të vazhdueshëm të decentralizimit, duke përfshirë edhe përmirësimin e kompetencave menagjeriale, ofrimi i shërbimeve dhe dialogu me qytetarë në nivel lokal, në një vijë me Standarde Evropiane .

Lista e projekteve me te cilat ka aplikuar Komuna e Gjilanit :

1. Ndërtimi i ndërtesës për Administraten Komunale – Gjilan.
2. Rruga Magjistrale Gjilan – Ferizaj / sektori Gjilan – Partesh.
3. Rregullimi i rrjetit të kanalizmit dhe shtratit të lumbit Stanishorka - Gjilan.
4. Rruga Magjistrale Gjilan – Prishtinë / sektori Gjilan – penda e Livoqit - L-3.300.
5. Ndërtimin e dy (2) objekteve për banim social – vendosjen e 50 familje skamnore - Gjilan

**DANIDA - Danish International Development Agency:** Qeveria daneze ka premtuar se do të vazhdojë me investime në disa komuna të Kosovës, duke përfshirë edhe Gjilanin, ku ka qëndruar të martën një delegacion qeveritar i këtij vendi. Falë donacioneve të "DANIDA" shkolla e bujqësisë "Arbëria" është pajisur me një laborator, ka serën e vetë, ku nxënësit kryejnë punën praktike. Po ashtu, ngritja e një pemishte në sipërfaqe prej një (1) hektari është financuar nga "DANIDA". Njëherësh, danezët, përmes kësaj organizate, do të investojnë edhe në ndërtimin e shkollës së mesme bujqësore "Arbëria". Gjatë muajit maj 2011 Danida ka shpallur tenderin për ndërtimin e objektit te shkolles së mesme bujqësore "Arbëria".

Ne saje te bashkëpunimit te mirë gjate muajit gushte "DANIDA" ka shprehe interesim që të investoj edhe në ndërtimin e një sere dhe investime ne 1.5 hektar per mbjelljen e hardhise se rrushit dhe fidaneve, komuna ka mare pjese pastrimin e terenit te sipërfaqes së lartpërmendurë .

Komuna e Gjilanit po e rrumbullakon gradualisht infrastrukturën shkollore, me daten 13 tetor 2011 në këtë komunë është vënë guthemeli i objektit të ri për shkollën e bujqësisë, një projekt ky që financohet nga qeveria daneze, përmes organizatës "Danida", që vepron në Kosovë.

**AAK - Asociacioni i Komunave të Kosovës :** Zyra e projekteve ka pas takime te rregullta rrethë hartimit te projekt dokumenteve rreth Bashëkpunimit Ndër Komunal. Në këtë takim ishin prezent edhe ekspert nga Maqedonia dhe Shqipëria të cilët kanë hartuar projekte të tilla dhe të cilat projekte janë implementuar në Maqedoni dhe Shqipëri. Kjo Iniciativë përkrahet nga zyra e UNDP në Kosovë dhe e cila ka zotuar që do të përkrah projektet komuanale që kanë për qëllim stimulimin e bashkëpunimit ndër komunal.

Asociacioni i Komunave të Sllovenisë (AKS) në bashkëpunim më Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) ka iniciuar idenë për themelim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave të mira mes institucioneve të vetëqeverisjes lokale të dy shteteve. Komuna e Gjilanit ka paraqiturë letër të interesit që dëshmon se ne jemi të interesuar përfuqizimin e marrëdhënieve mes Komunës së Gjilanit dhe Komunave Sllovene konkretisht Komunës Celje ose Komuna Kranj, ndërsa fusha në të cilën mendojm të bashkëpunojm janë : parku industrial & inkubatorët e biznesit – zonat ekonomike, bashkëpunimi ndërkombinal dhe ndërkufitarë, trajtimi i ujërave të zeza – impiante, riciklimi i mbeturinave, partneriteti publiko privat .

**ICMPD – International Centre for Migration Policy Development :** Zyra e projekteve ka një bashkëpunim te mirë me këtë projekti i cili është bashkëfinancuar nga fondi European për Kthim dhe Ministria Federale e Punëve të Brendshme e Austrisë, ndërsa qëllimi i projektit ëshë që të kontriboj në kthimin e qëndrushëm të imigrantëve në Kosovë .

**CARE International :** Zyra e projekteve ka një bashkëpunim të mirë me këtë projekt i cili është financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit European, projekti ka për qëllim të krijojë një Qendër të Biznesit e cila do të ndihmojë burrat dhe gratë që aspirojnë përfilluar një biznes të ri, ndërsa njerëzit e bizneseve ekzistuese do të ndihmohen përfilluar rritur ndërmarrjet e tyre me krijimin e një ambienti më të favorshëm të biznesit. Kjo qendër do të mbështesë krijimin e punësimit, së bashku me aktivitetet e synuara, turizmit, bagëtisë dhe bujqësisë. Komuna e Gjilanit si bashkë implementuese e këtij projekti ka siguruar një zyre (te objekti i Inkubatorit të Biznesit) për stafin drejtues i cili do të menaxhoj realizimin e projektit .

Organizata Care Internacionale per mes Qendres se Bizneit ka realizuar disa trajnime per bujqit dhe biznesete e regionit te Gjilanit po ashtu kjo organizat ka pas edhe disa vizita ne Maqedoni dhe Shqipëri përfte cilat kan pas ne fokus zhvillimin e bujqësies dhe turizmit rural .

Organizata Care Internacionale per mes Qendres se Bizneit dhe Drejtoris së Bujqësisë ka arritur te realizoj projektin e grumbullimit, përpunimit dhe paketimit të qumështit të dhisë, kjo organizat ka dhene edhe një (kamion-llantofriz) per kete pike grumbulluese e cila kap vleren 40.700€, në bazë të vlersimit në teren kjo pikë grumbulluese dhe përpunuese e qumështit te dhise i është dhënë fermerit Avni Syla nga Bresalci .

Në fundë të vitit në një ceremoni të organizuar nga organizata CARE, drejtuesit e institucioneve lokale dhe qendrore e ndërkombëtare kanë bërë dorëzimin e certifikatave përf 80 fermerë, 11 zyrtarë komunalë, 11 profesorë të shkollës së mesme të Bujqësisë, 80 bletarë si dhe 124 drejtues të bizneseve të vogla dhe të mesme, të cilët i kanë ndjekur këto trajnime.

## **Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (IOM) & Këshillit Danez për Refugjatë (DRC) :**

Bashkimi Evropian (Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO) ka ndarë një projekt mbi 5 milionë euro në nivel të Kosovës për të adresuar varfërinë dhe papunësinë afatgjate nëpërmjet masave aktive të tregut të punës duke promovuar mundësi për punë të lidhura me skemat publike të rigjenerimit që rrisin cilësinë e jetës për të gjithë banorët e Kosovës. *Programi i EU-së Kosova e Bukur*. Programi EU-BK implementohet nga IOM në partneritet me DRC në. Komuna e Gjilanit – zyra e projektve gjatë muajit korrik 2011 shprehë interesim dhe ka aplikuar në EU programin “Kosova e Bukur” me këto projekte : Ndërtimi i Qendrës Sportive (terreneve sportive) mbi palestrën e sporteve, Fasadimi i objektive kolektive “Lagjeja Iliria” faza II, Krasitja e pishave te penda e Livoqit .

